



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	190 / 15
Nr. i fq. / Br. st	- 39 -
Data / Datumi	29.09.2015
VUSHTRRI - VUÇITRN	



## Republika e Kosovës

## Kuvendi i Komunës- Vushtri

Bazuar në Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 3, nenit 10 paragrafi 2 në lidhje me nenin 15 paragrafi 1 nën paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-060 për mbeturina, Nenin 12 pika (d) si dhe Nenin 17.1, pika (f) të Ligjit 03/L-40 mbi Vetëqeverisje Lokale, Nenin 41.2 pika (ç) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2015, mori këtë:

### V E N D I M

#### PËR APROVIMIN E PLANIT PESËVJEÇARË TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE 2016 -2020

1. Me këtë Vendim aprovohet Plani Pesëvjeçar i Menaxhimit të Mbeturinave për periudhën 2016 – 2020.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin “Plani Pesëvjeçar i Menaxhimit të Mbeturinave 2016 - 2020”.
4. Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova  
Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës  
Komuna e Vushtrrisë

---

**PLANI PESË-VJEÇAR I MENAXHIMIT TË  
MBETURINAVE PËR KOMUNËN E  
VUSHTRRISË**

**2016 - 2020**

Shtator 2015

## PËRMBAJTJA

### KAPITULLI I

1.Profili i Komunës.....	3
1.1 Pozita gjeografike.....	3
1.2 Kushtet klimatike.....	3
1.3 Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë .....	4
1.4 Vendbanimet dhe tipet e vendbanimeve.....	5

### KAPITULLI II

1. Objektivat e Planit të Menaxhimit të Mbeturinave .....	7
2.1 Baza ligjore e Planit për Menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrisë.....	7
2.2 Sfondi.....	8
2.3 Zona e synuar.....	9
2.4 Qëllimi i planit.....	9
2.5 Viti i synuar.....	9

### KAPITULLI III

3.Gjendja aktuale e menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Vushtrisë.....	9
3.1 Rrjedha e mbeturinave.....	9
3.1.1 Gjendja dhe problemet aktuale të menaxhimit të mbeturinave.....	13

### KAPITULLI IV

4.Plani lokal i menaxhimit të mbeturinave.....	18
4.1 Supozimet për planifikim.....	18
4.1.1 Shkalla e rritjes së popullsisë dhe ngritjes ekonomike.....	18
4.1.2 Sasia dhe përbërja e mbeturinave në të ardhmen.....	19
4.1.3 Rrjedha e mbeturinave në të ardhmen, pa planifikim .....	22
4.2 Politika bazë.....	23
4.3 Viti i synuar për implementim .....	23
4.4 Synimi numerik .....	23
4.5 Strategjia .....	24
4.5.1 Mënyra e menaxhimit të mbeturinave .....	24
4.5.2 Strategjia për të arritur synimin .....	26
4.6 Rrjedha e mbeturinave në të ardhmen .....	28

## KAPITULLI V

5. Plani i implementimit .....	29
5.1. Aktivitetet prioritare .....	29
5.1.1 Fuqizimi i sistemit teknik.....	29
5.1.2 Fuqizimi i sistemit institucional.....	31
5.2 Orari i implementimit .....	33
5.3 Vlerësimi i kostos .....	34
5.3.1 Kushtet për vlerësimin e kostos .....	34
5.3.2 Burimet e fondit .....	35

## KAPITULLI VI

6. Strategjia e implementimit të planit pesëvjeçar për menaxhimin e mbeturinave .....	35
6.1 Publikimi dhe promovimi i planit të menaxhimit të mbeturinave.....	35
6.2 Krijimi i një ambienti të pastër përmes menaxhimit të mbeturinave drejt një shoqërie të shëndoshë .....	35
6.2.1 Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare .....	35
6.2.2 Të sigurohet shërbimi i duhur i grumbullimit të mbeturinave .....	36
6.2.3 Promovimi i aktiviteteve të 3R .....	36
6.2.4 Promovimi i pjesëmarrjes publike .....	37
6.3 Qartësimi i përgjegjësive të qytetarëve, bizneseve dhe qeverisë .....	37
6.3.1 Qytetarët.....	37
6.3.1.1 Pagesa e taksës për mbeturina .....	37
6.3.1.2 Praktikat e 3R .....	37
6.3.1.3 Respektimi i rregullave të shkarkimit.....	38
6.3.1.4 Bashkëpunimi aktiv në plan .....	38
6.3.2 Bizneset afariste .....	38
6.3.2.1 Parimi ndotësi paguan.....	38


# Kapitulli I

## 1 PROFILI I KOMUNËS

### 1.1 Pozita gjeografike

Territori i Komunës së Vushtrrisë gjendet në pjesën veriore të Kosovës. Komuna ka formë të zgjatur në drejtim të veriut (gjatësia max. afër 34 km) dhe është më tepër e zgjeruar në mes (gjerësia max. 23 km) dhe me një gjatësi të vijës kufitare prej afro 104,5 km.

Ka një pozitë të mirë gjeografike dhe kufizohet me pesë komuna të tjera: Komunën e Mitrovicës, të Skenderajt, Drenasit, Obiliqit dhe Besianës. Po ashtu, ka edhe një lidhje hekurudhore të rëndësishme me Fushë-Kosovën, si nyje hekurudhore dhe Mitrovicën.



Territori i Komunës së Vushtrrisë ka një sipërfaqe prej 345 km<sup>2</sup> dhe zë një hapësirë rreth 3.5 % të territorit të Kosovës. Këtë sipërfaqe e përbën një reliev i ndryshëm, me terren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rreth lumit “Silnica” dhe lumit “Llap”, ndërsa pjesët tjera të relievit në perëndim shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në lindje, po ashtu, në kodra e lugina të maleve të Shalës së Bajgorës.

### 1.2 Kushtet klimatike

Territori i Komunës ju nënshtrohet ndikimeve klimatike nga pellgu i Silnicës dhe ai i Ibrit. Ka mikroklimë me specifikat e veta në të cilën kanë ndikuar proceset kimiko-teknologjike, si rrjedhojë e zhvillimeve nga industria energjetike (KEK) në jug dhe industria e rend metalurgjike (Trepça) në veri. Territori ka një shkallë të lartë të lagështisë relative që varion nga 95 % - 47 %, përderisa kufijtë normal zakonisht janë prej 45-56 %.

Temperatura e ajrit është e ndryshueshme, ku vlera mesatare vjetore është 10.2°C, nga që muaji më i ftohtë është Janari me -1.5°C, përderisa muaji më i nxehtë është Gushti me temperaturë mesatare vjetore në 20.5°C. Amplituda vjetore e temperaturës së ajrit është 21.9°C, ku me vlerat ekstreme dhe me elementet tjera krijojnë klimën e regjimit kalimtar në mes të klimës mesatare kontinentale të ashpër malore, kur vjeshta është më e nxehtë se pranvera për 1.5°C.

Në regjimin e reshjeve atmosferike të territorit dhe rrethinës, ndikim parësorë kanë aktivitetet ciklonike me prejardhje të ndryshme të cilat manifestohen gjatë rrugëtimit të masave ajrore me shkallë të lartë të lagështisë dhe të ftohta nga Atlantiku, ndërsa ato të nxehtat nga Jugu nga hapësira Mesdhetare, si dhe ato që depërtojnë gjatë dimrit si masa të ftohta të ajrit që vijnë nga Veriu dhe Veri-Lindja. Sasia e reshjeve ndryshon nga 670 - 810 mm.

### 1.3 Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë

Struktura e popullsisë ka rëndësi të madhe për zhvillimin demografik, ekonomik dhe social. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyçe të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik të një popullate.

Komuna ka popullsi kryesisht të re, edhe pse në periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja. Mbi 35 % e popullsisë së përgjithshme në këtë zonë janë me moshë të re, 0 deri 18 vjeç. Ndërsa, grup-moshat 19-35 vjeç e përbën mbi 25% të popullsisë, grup moshë 36-65 vjeç përfshinë rreth 35 % dhe moshë mbi 66-vjeç e popullsisë përfshinë 4.9% të popullsisë së përgjithshme. Këto të dhëna më së miri tregojnë se kjo zonë, si edhe e tërë Kosova ka një popullsi të re me rreth 60 % të saj nën moshën 35-vjeçare.

- Numri i banorëve në komunën e Vushtrrisë sipas regjistrimit të vitit 2011 vlerësohet mbi 69 870 banorë.
- Në qytet jetojnë 26,964 banorë (afërsisht 1/3 e popullsisë).
- Në fshatra jetojnë 42,906 banorë.
- Dendësia mesatare e popullsisë është rreth 202 ban/km<sup>2</sup> (mbi mesataren e Kosovës).
- Rritja mesatare vjetore e popullsisë në këtë komunë është 0.21%.
- Ekziston dallim i vogël në strukturën gjinore (51 % meshkuj dhe 49% femra).
- Etnitetet që jetojnë në këtë komunë janë: shqiptarë ~92%; serbë ~4 %; malazezë ~3%; turq; ashkalinj; romë ~1%.
- Vlerësohet se në komunën e Vushtrrisë ka 49.200 pjesëtarë të popullsisë aktive, prej, tyre 40% femra dhe 60% meshkuj.
- Mundësia e rritjes së popullsisë aktive vlerësohet në 2.1% për një vit.
- Gjithsej në këtë komunë janë afër 11 872 familje, me mesataren 5.8 anëtarë.

**Migrimet e popullsisë** sot paraqesin një problem shumë dimensional hapësinor, demografik, ekonomik, social dhe politik, ndërsa i nxisin një varg faktorësh të ndërlikuar dhe shpesh herë reciprocikisht të lidhur e të kushtëzuar. Mungesa e të dhënave demografike në përgjithësi dhe për migrimet në veçanti, vështirëson punën dhe arritjen deri të rezultatet e sakta mbi migrimet për këtë zonë. Sipas vlerësimeve të ndryshme, mund të thuhet se ka migrime të theksuara kryesisht nga viset me të thella rurale drejt atyre urbane. Mirëpo, nuk duhet harruar se kemi të bëjmë edhe me migrime jashtë vendit, të cilët përbëjnë një numër të madh të popullatës. Shkaqet që i kanë kushtëzuar këto migrime janë të natyrave të ndryshme, duke përfshirë ato ekonomike dhe të punësimit, sociale, demografike, politike etj. Shkaqet ekonomike dhe punësimi janë ndër faktorët kryesor që i kanë kushtëzuar këto migrime, për faktin se në vendin tonë një numër i konsiderueshëm nuk kanë mundur të gjejnë punë dhe si zgjidhje e vetme për të siguruar kushte më të mira të jetesës ishte emigrimi në botën e jashtme.

#### 1.4 Vendbanimet dhe tipi i vendbanimit

Në kuadër të territorit administrativ të komunës së Vushtrrisë gjenden 67 vendbanime (65 zona kadastrale dhe 2 lagje, Sfarçaku i Epërm i takon Vushtrrisë dhe Mavriqi i cili i takon Zonës Kadastrale Pestovë). Pjesa dërmuese e tyre kanë strukturë homogjene etnike. Sipas regjistrimit dhe vlerësimit të popullsisë më 1991, të organizuar pa pjesëmarrje të shqiptarëve, në komunën e Vushtrrisë 35 vendbanime kanë qenë të banuara vetëm me popullsi shqiptare, 28 me popullsi të përzier, disa nga te cilat me numër shumë të vogël të minoritetit serb, malazez apo romë dhe vetëm 4 vendbanime me popullsi dominuese serbe (Gojbula, Graca, Preluzha, Miraça).

Vendbanimet e komunës sipas numrit të banorëve dhe largësisë nga qendra janë:

Nr.	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Lrgësia qytet-fshatra	Nr .	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Lrgësia qytet-fshatra
1	Akrashticë	1113	7km	35	Nedakoc	268	4 km
2	Banjskë	891	5 km	36	Novolan	1366	6 km
3	Balincë	323	7 km	37	Oshlan	488	11 km
4	Beqiq	227	14 km	38	Pantinë	1422	7 km
5	Bequk	487	19 km	39	Pasomë	744	8 km
6	Begaj	1261	3 km	40	Pestovë	842	6 km
7	Bivolak	730	17 km	41	Prelluzhë	558?	14 km
8	Boshlan	5	17 km	42	Resnik	1366	8 km
9	Brusnik	404	8 km	43	Ropicë	763	9 km
10	Bukosh	1171	5 km	44	Samadrexhë	1321	11 km
11	Ceceli	357	14 km	45	Sfaraçak i Epërm	353	6 km
12	Dalak	786	4 km	46	Sfaraçak i Poshtëm	522	4 km
13	Dobërllukë	1629	4 km	47	Shalë	541	12 km
14	Druar	965	9 km	48	Shlivovicë	14	9 km
15	Duboc	493	12 km	49	Shtitaricë	788	4 km
16	Dumnicë e Epërme	284	15 km	50	Skoçen	5	11 km
17	Dumnicë e Llugës	656	12 km	51	Skromë	114	13 km
18	Dumnicë e Poshtme	1379	9 km	52	Sllakoc	263	17 km
19	Galicë	234	14 km	53	Sllatinë	491	4 km
20	Gllavatin	391	16 km	54	Smrekonicë	1646	6 km
21	Gojbulë	588	4 km	55	Stanoc i Epërm	2051	11 km
22	Gracë	424	13 km	56	Stanoc i Poshtëm	1736	12 km
23	Gumnishtë	65	18 km	57	Stroc	865	19 km
24	Hercegovë	423	10 km	58	Studime e Epërme	335	9 km
25	Karaçë	192	7 km	59	Studime e Poshtme	777	4 km
26	Kollë	554	8 km	60	Taraxhë	54	7 km
27	Kunovik	13	19 km	61	Tërllobuq	125	7 km
28	Kurillov	14	19 km	62	Vërrnicë	612	6 km
29	Liqej	318	7 km	63	Vesekoc	40	21 km
30	Lummadh	117	10 km	64	Vilanc	387	8 km
31	Mavriq	404	4 km	65	Vushtrri	26964	-
32	Maxhunaj	2035	7 km	66	Zagorë	18	14 km
33	Mihaliq	1242	12 km	67	Zhilivodë	496	21 km
34	Miraçë	10	5 km				

Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrave urbane dhe janë kryesisht vise rurale, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë. Në shumicën e vendbanimeve kemi banim individual, kurse në Vushtri kemi banim të përzier kolektiv dhe individual. Vendbanimet që ndodhen afër qendrave urbane dhe atyre afër rrugëve vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikative, për këtë arsye objektet e banimit, si dhe ato të bizneseve, shtrihen në formë vargore. Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në hapësirat e rrafshëta urbane, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjeve në hapësirat e banimit, kjo zonë gjithashtu disponon me një fond banesor mjaftë cilësor.

Komuna	Gjithsej	Perkatesise etnike/kulturore										Preferon te mos pergjigjet	Nuk eshte ne dispozicion	
		Shqiptare	Serb	Turq	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Goran	Te tjere				
Kosove	Gjithsej	1,739,825	1,616,869	25,532	18,738	27,533	8,824	15,436	11,524	10,265	2,352	912	1,840	
	Meshkuj	875,900	814,986	13,038	9,303	13,295	4,396	7,855	5,761	5,133	889	446	798	
	Femra	863,925	801,883	12,494	9,435	14,238	4,428	7,581	5,763	5,132	1,463	466	1,042	
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
Vushtri	Gjithsej	69,870	68,840	384	278	33	68	143	1	3	50	17	53	
	Meshkuj	36,004	35,503	197	140	1	34	75	-	1	22	10	21	
	Femra	33,866	33,337	187	138	32	34	68	1	2	28	7	32	



## Kapitulli II

### 2. Objektivat e planit për menaxhim të mbeturinave

Që nga Qershori i viti 2012 kur ka hyrë në fuqi Ligji mbi mbeturinat (Ligji nr.04/L-060), sipas politikave të Qeverisë, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve si dhe shërbimet tjera të pastrimit, i janë deleguar autoriteteve lokale përmes promovimit të decentralizimit. Pra ky ligj delegon më shumë autoritet dhe përgjegjësi te qeverisja lokale sa i përket menaxhimit të mbeturinave.

Komuna e Vushtrrisë ka filluar me “Projektin për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një „Ambienti të pastër”, me ndihmën e projektit për partneritet me Komunën Vëxjë që nga tetori i vitit 2014 dhe ka hartuar Planin për Menaxhimin e Mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë (draftin e parë) duke synuar vitin 2020, i bazuar tërësisht në rezultatet e një studimi përmbajtësor. Ky plan i menaxhimit të mbeturinave korrespondon me ligjin mbi mbeturinat dhe Strategjinë Kombëtare për menaxhimin e mbeturinave si një plan afat mesëm.

Si rezultat i nismës për partneritet ndërmjet dy komunave, grupi punues nga Komuna e Vushtrrisë ka realizuar vizita studimore në komunën Vëxjë, si dhe vizita mbështetëse në Vushtrri të grupit punues nga Komuna Vëxjë. Po ashtu janë analizuar praktikat e deritanishme të disa komunave të regjionit.

Prandaj Komuna e Vushtrrisë ka hartuar këtë plan 5 vjeçar për menaxhimin e mbeturinave në bazë të përvojës së fituar, nevojave për një ambient të pastër dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit për Mbeturina si dhe Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2012-2021.

#### 2.1 Baza ligjore e planit për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë

Plani pesëvjeçar për menaxhimin e mbeturinave është hartuar në bazë të nenit 17 shkronja f të ligjit me Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të neneve 8, 10 dhe 15 pika 8 të ligjit me Nr.04//L-060 për mbeturinat si dhe nenit 79 pika (o) të statutit të Komunës së Vushtrrisë të cilat figurativisht janë të paraqitura në fig. 1.

Ky plan pesëvjeçar i menaxhimit të mbeturinave është strategji afat mesme e menaxhimit të mbeturinave dhe përmbajtja e tij parasheh përmbledhjen e aktiviteteve në pesëvjeçarin e ardhshëm.




Figura 1: Baza Ligjore e Planit për MM

## 2.2 Sfondi

Që nga Qershori i viti 2012 kur ka hyrë në fuqi Ligji mbi mbeturinat (Ligji nr.04/L-060), sipas politikave të Qeverisë, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve si dhe shërbimet tjera të pastrimit, i janë deleguar autoriteteve lokale përmes promovimit të decentralizimit. Pra ky ligj delegon më shumë autoritet dhe përgjegjësi te qeverisja lokale sa i përket menaxhimit të mbeturinave.

### 2.3 Zona e synuar

Zona e synuar në Planin e menaxhimit të mbeturinave, është e tërë zona e përgjegjësisë së Komunës së Vushtrrisë, 67 vendbanime me gjithsej 345 km<sup>2</sup>.

### 2.4 Qëllimi i planit

Plani i menaxhimit të mbeturinave synon shtrirjen e ofrimit të shërbimit për menaxhimin e të gjitha mbeturinave komunale në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Në këtë plan pesëvjeçar të menaxhimit të mbeturinave, nuk janë të përfshira mbeturinat industriale, mbeturinat e rrezikshme dhe mbetjet mjekësore (mbetjet infektive) të cilat do të trajtohen nën kontrollin e Qeverisë së Kosovës.

### 2.5 Viti i synuar

Viti i synuar i planit për menaxhimin e mbeturinave për menaxhimin e tërësishëm të mbetjeve është viti 2020 ndërsa synimi i ndërmjetëm është viti 2018.

## KAPITULLI III

### 3 Gjendja aktuale e menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë

#### 3.1 Rrjedha e mbeturinave

Zhvillimi i rrjedhës së mbeturinave është shumë i rëndësishëm për të mësuar gjendjen aktuale të menaxhimit të mbeturinave. Ekipi i grupit punues për hartimin e këtij plani apo projekti për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një ambienti të pastër, ka hartuar rrjedhën e mbeturinave bazuar në rezultatet e studimeve përmbajtësore.

Prandaj, rrjedha e mbeturinave është hartuar bazuar në kriteret e mëposhtme:

**Mbeturinat e amvisërisë:** Sasia e gjeneruar është vlerësuar duke llogaritur numrin e popullsisë që ka dalë nga regjistrimi i vitit 2011, së bashku me rritjen mesatare vjetore të popullsisë që është 0.21% dhe shkalla e gjenerimit është marrë nga studimi i sasisë dhe përbërjes së mbeturinave. Shkalla e gjenerimit është mesatarja e shkallës në verë dhe dimër. Sidoqoftë, ndryshimi në mes të shkallës së gjenerimit në zonën urbane dhe rurale dallon në mënyrë të konsiderueshme, kështu që është kalkuluar edhe sasia e gjeneruar e mbeturinave të amvisërisë së atyre zonave.

**Mbeturinat nga Bizneset afariste:** Kjo është vlerësuar me sasinë e mbeturinave të gjeneruara nga restorantet, lokalet, hotelet etj. të cilat janë studiuar nga grupi punues. Numri i burimeve gjeneruese është marrë nga të dhënat e siguruar nga lejet e bizneseve që janë lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë më 2014. Sasia e gjeneruar është vlerësuar me shkallën e gjenerimit të dhënë nga *studimi i sasisë dhe përbërjes së mbeturinave* (SSPM) dhe me numrin e burimeve gjeneruese.

**Mbeturinat nga hapësirat publike:** Sasia e gjeneruar është vlerësuar bazuar në rezultatet e sasisë së përgjithshme të shkarkuara e të regjistruara në *Deponinë Regjionale të mbeturinave në Mitrovicë* (DRM).

Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrave urbane dhe janë kryesisht vise rurale, të cilat janë fshatra tipike bujqësore

**Shkalla e Riciklimit:** Gjatë hartimit të këtij plani janë marrë në konsideratë tri opsione riciklimi.


E para është riciklimi te burimi gjenerues që e quajmë „Riciklimi në vend”, si kompostimi i mbetjeve nga kuzhina me anë të metodës tradicionale. E dyta është ndarja e gjërave të riciklueshme nga mbeturinat siç e quajmë „Grumbullimi i gjërave të riciklueshme”, ku përfshihen punëtorët e grumbullimit të mbeturinave dhe mbledhësit e mbeturinave. E fundit është ndarja për trajtim të ndërmjetëm siç e quajmë „Riciklimi larg vendit”, i cili kryhet nga kompanitë private të grumbullimit për të reduktuar sasinë e shkarkuar. Sasia e ricikluar e secilit aktivitet është vlerësuar bazuar në rezultatet e studimit të opinionit publik dhe të dhënat nga kompania e mirëmbajtjes dhe pastrimit.

**Shkalla e vetë-shkarkimit:** Vetë-shkarkim do të thotë groposje ose djegie e mbeturinave te burimi gjenerues. Sasia e vetë shkarkuar nga amvisëria dhe bizneset afariste vlerësohen si 0.4ton/ditë apo 1.44 % e sasisë së gjeneruar në zona urbane dhe 0.75ton/ditë apo 2.79 % e sasisë së gjeneruar në zona rurale, bazuar në rezultatet e prezantuara nga KRM „Uniteti” gjatë SSPM si dhe studimi i opinionit publik (SOP).


Pasi që ka një dallim të madh në mes të zonës urbane dhe zonës rurale, janë trajtuar tri rrjedha të mbeturinave; **e tërë zona, zona urbane dhe zona rurale.**

Rrjedha e mbeturinave e secilit vit që nga viti 2015 deri 2020 paraqitet në këtë plan pesëvjeçar të menaxhimit të mbetjeve. Prandaj, rrjedhat e mbeturinave të referuara në këtë plan pesë vjeçar janë vlerësuar bazuar në rezultatet e studimit.


Rrjedha e mbeturinave në tërë zonën 2014



Rrjedha e mbeturinave në zonën urbane 2014



Rrjedha e mbeturinave në zonën rurale 2014



### 3.1.1. Gjendja dhe problemet aktuale të menaxhimit të mbeturinave

Pikat	Gjendja aktuale	Aspektet																									
1. Sistemi Teknik																											
1.1 Gjenerimi i mbeturinave	<p>Popullsia sipas regjistrimit: me 2011, me 2015</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tërësia: 69,870 75,629</li> <li>- Zona Urbane: 26,964 29,186</li> <li>- Zona Rurale: 42,964 46,443</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zona komunale: 345 km<sup>2</sup></li> <li>• Gjenerimi i mbeturinave</li> </ul> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Pikat</th> <th>Njësi</th> <th>Tërësi</th> <th>Urbane</th> <th>Rurale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Gjenerimi I MK</td> <td>ton/ditë</td> <td>54.6</td> <td>27.7</td> <td>26.9</td> </tr> <tr> <td>Shkalla e MK</td> <td>g/p/ditë</td> <td>722</td> <td>949</td> <td>579</td> </tr> <tr> <td>Gjenerimi mbet në MK</td> <td>ton/ditë</td> <td>54.60</td> <td>27.70</td> <td>26.90</td> </tr> <tr> <td>Shkalla e mbet.Amv</td> <td>g/p/ditë</td> <td>528</td> <td>521</td> <td>535</td> </tr> </tbody> </table>	Pikat	Njësi	Tërësi	Urbane	Rurale	Gjenerimi I MK	ton/ditë	54.6	27.7	26.9	Shkalla e MK	g/p/ditë	722	949	579	Gjenerimi mbet në MK	ton/ditë	54.60	27.70	26.90	Shkalla e mbet.Amv	g/p/ditë	528	521	535	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktualisht 98.2% e mbeturinave të gjeneruara shkarkohet pa ndarje në burim.</li> </ul>
Pikat	Njësi	Tërësi	Urbane	Rurale																							
Gjenerimi I MK	ton/ditë	54.6	27.7	26.9																							
Shkalla e MK	g/p/ditë	722	949	579																							
Gjenerimi mbet në MK	ton/ditë	54.60	27.70	26.90																							
Shkalla e mbet.Amv	g/p/ditë	528	521	535																							
1.2 Përbërja e mbeturinave	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbetje komunale: Mbetje nga kuzhina (42.38%), të riciklueshme (27.1%), mbetje tjera (30.52%),</li> <li>• Mbetje nga amvisëria (urbane): Mbetje nga kuzhina (58.1%), të riciklueshme (22.7%), mbetje tjera (19.2%)</li> <li>• Mbetje nga amvisëria (rurale): Mbetje nga kuzhina (34.2%), të riciklueshme (21.8%), Mbetje tjera (44.0%)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbetjet nga kuzhina kanë përbërjen e 58.10% që është më e larta e gjithë mbetjeve komunale.</li> <li>• Të riciklueshmet përbëhen nga 27.1% e mbetjeve komunale.</li> </ul>																									
1.3 Ruajtja & shkarkimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 42% e amvisërive ruan mbeturinat në qese plastike ose të letrës dhe 46% në kontejnerë.12% hedhje ilegale.</li> <li>• Rreth 42% e amvisërive shkarkon mbeturinat një here në javë por 26% shkarkojnë më shumë se dy herë.</li> <li>• 72 % e bizneseve afariste shkarkojnë mbeturinat më tepër se dy herë në javë, pjesa tjetër një herë në javë.</li> <li>• Mbeturinat sillen edhe nga zona tjera.</li> <li>• Mbetjet me përmasa të mëdha shkarkohen së bashku me mbeturinat.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjysma e banorëve kërkon shtimin e frekuencës së grumbullimit.</li> <li>• Mënyra e shkarkimit është e keqe.</li> <li>• Mbeturinat derdhen rreth kontejnerëve.</li> <li>• Mbeturinat shkarkohen pasi të jetë bërë shërbimi i grumbullimit.</li> <li>• Disa banorë shkarkojnë mbeturinat në pika tjera të shkarkimit.</li> </ul>																									

<p>1.4 Grumbullimi &amp; transportimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkalla e grumbullimit të mbeturinave është 65.9 % në tërë zonën komunale, 70% në zonën urbane dhe 30% mbeturinat nga zona rurale.</li> <li>• 32-34 % e mbeturinave të gjeneruara shkarkohet ilegalisht dhe 15-16 % e tyre largohet nga Uniteti.</li> <li>• Shërbimi i grumbullimit për amvisëri dhe biznese afariste kryhet nga kompania publike (Uniteti).</li> <li>• Kualiteti i shërbimit të Unitetit është i pamjaftueshëm për shkak të mungesës së kapaciteteve në mekanizëm. Në anën tjetër, nuk kemi kompani private të kontraktuara për ofrimin e këtyre shërbimeve.</li> <li>• Grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave të gjeneruara në KFOR që gjendet në f.sh. Maxhunaj deri në fund të vitit 2014 KRM UNITETI Njësia në Mitrovicë ndërsa aktualisht grumbullimin e bëjnë kompania private. Grumbullimi i mbeturinave derë më derë i</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Edhe pse shërbimi i grumbullimit mbulon të gjithë zonën urbane, ende ka pika ilegale të hedhjes.</li> <li>• Shumë pika ilegale të hedhjes ka përgjatë rrugës në fshatra.</li> <li>• Puna e grumbullimit merr kohë për shkak të kontejnerëve të dëmtuar (pa mirëmbajtje).</li> <li>• Puna e grumbullimit merr kohë sepse punëtorët duhet të pastrojnë hapësirën rreth kontejnerëve.</li> <li>• Veç kësaj bëhet edhe grumbullimi i mbeturinave</li> </ul>
---	---	--

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Grumbullimi me kontejnerë komunal ofrohet në zonat me banim kolektiv.</li> <li>• Grumbullimi me kontejner aplikohet për bizneset afariste.</li> <li>• Frekuenca e grumbullimit për grumbullim skaj rrugës është një herë në javë, për kontejnerë komunal çdo ditë.</li> <li>• Pagesa e mbeturinave është e caktuar dhe e aprovuar nga ZRRUM sipas vlerësimit të bërë nga Uniteti.</li> <li>• Amvisëria derë më derë dhe me kontejner është 4.40 euro/muaj</li> </ul> <p>Pagesa për klient komercial/industrial është kategorizuar në tabelën e mëposhtme.</p> <table border="1" data-bbox="464 1464 1043 1630"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Klientët</th> <th rowspan="2">Njësi</th> <th colspan="3">Tarifa</th> </tr> <tr> <th>Vogël</th> <th>Mesatar</th> <th>Madhe</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Komercial/industrial</td> <td>€/muaj</td> <td>5.80</td> <td>11.50</td> <td>19.40</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">Kontejnerë të caktuar</td> <td rowspan="2">€/rrugëtim</td> <td>(1.1m<sup>3</sup>)</td> <td>(7.0m<sup>3</sup>)</td> <td></td> </tr> <tr> <td>13.25</td> <td>50.68</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Klientët	Njësi	Tarifa			Vogël	Mesatar	Madhe	Komercial/industrial	€/muaj	5.80	11.50	19.40	Kontejnerë të caktuar	€/rrugëtim	(1.1m <sup>3</sup> )	(7.0m <sup>3</sup> )		13.25	50.68		<p>të përmasave të mëdha.</p>
Klientët	Njësi			Tarifa																			
		Vogël	Mesatar	Madhe																			
Komercial/industrial	€/muaj	5.80	11.50	19.40																			
Kontejnerë të caktuar	€/rrugëtim	(1.1m <sup>3</sup> )	(7.0m <sup>3</sup> )																				
		13.25	50.68																				
<p>1.5 Pastrimi i hapësirave publike</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapësirat publike si rrugët dhe parqet publike që menaxhohen nga Komuna dhe kontrahohen nga Uniteti dhe kompani private.</li> <li>• Ofruesit e Shërbimeve zgjidhen çdo Dhjetor dhe kontrahohen për periudhën prej Janarit deri në Dhjetor.</li> <li>• Heqja e pikave ilegale në zone urbane deri tani janë eliminuar nga Uniteti.</li> <li>• Shuma e përgjithshme e kontratës është €68,670 me 2014-2015.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbeturinat hidhen në lumenj.</li> <li>• Mbeturinat janë të shpërndara në parqet e vogla që gjenden në zonat e banimeve kolektive.</li> <li>• Mbeturinat derdhen nga ata kontejnerë të instaluar në parqe.</li> </ul>																					



1.6 Riciklimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkalla e Riciklimit për sasinë e përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara është 3.29%.</li> <li>• Aktivitetet e Riciklimit kryhen nga sektori joformal.</li> <li>• Në zona rurale bëhet kompostimi në mënyrë tradicionale por është shumë i kufizuar.</li> <li>• Gjërat e riciklueshme ndahen nga punëtorët e grumbullimit gjatë shërbimit të grumbullimit.</li> <li>• Kompani private kanë improvizuar hapësira për grumbullim dhe ndarje të mbeturinave dhe nxjerrë 3.29 % të gjërave të riciklueshme me anë të ndarjes manuale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitetet e Riciklimit kryhen nga sektori joformal.</li> <li>• Komuna e Vushtrisë është duke promovuar aktivitetet e Riciklimit.</li> <li>• Aktualisht është duke u ndërtuar objekti në fsh. Bukosh i cili ka për qëllim riciklimin e mbetjeve të riciklueshme</li> </ul>
1.7 Deponimi final	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Deponia regjionale është ndërtuar si deponi sanitare me 11 ha hapësirë e dizajnuar me kapacitet 2.5 mil m<sup>3</sup> financuar nga DANIDA në vitin 2001 në Mitrovicë.</li> <li>• Deponia në Gërmovë të Mitrovicë menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave UNITETI.</li> <li>• Aktualisht sasia ditore e deponuar është 36 ton/ditë (27.57ton/ditë nga Vushtrria, 8.43 ton/ditë jashtë Vushtrrisë sipas vitit 2014)</li> <li>• Tarifa e deponimit definuar nga ZRRUM: 6.10€/ton</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapaciteti i mbetur i deponisë është deri në vitin 2025.</li> <li>• Deponia e Gërmovës nuk operohet si duhet për shkak të mungesës së mjeteve adekuate.</li> </ul>

1.8 Mirëmbajtja e pajisjeve	<p>Pajisjet që i takojnë njësisë punuese Uniteti në Vushtrri janë si më poshtë janë. 2015:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Pajisjet</th> <th>Sasia/copë</th> <th>Viti i prodhimit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>Kompaktor IVECO</td><td>2</td><td>2001</td></tr> <tr><td>Minikomptaktor Mitsubishi</td><td>1</td><td>2009</td></tr> <tr><td>Minikomptaktor Mitsubishi</td><td>1</td><td>2010</td></tr> <tr><td>Minikomptaktor Mitsubishi</td><td>1</td><td>2014</td></tr> <tr><td>Kamiona transportues SKANI P3</td><td>1</td><td>1990</td></tr> <tr><td>Kamiona transportues IVECO</td><td>1</td><td>2001</td></tr> <tr><td>Kamion kiper 8 t Mercedes 2222</td><td>1</td><td>1985</td></tr> <tr><td>Kamion kiper 11 t Mercedes 1717</td><td>1</td><td>1981</td></tr> <tr><td>Kamion UNIMAG</td><td>1</td><td>1987</td></tr> <tr><td>Traktor IMT 539</td><td>4</td><td>2001</td></tr> <tr><td>Lugë ngarkuese ULT 160C</td><td>1</td><td>1987</td></tr> <tr><td>Auto Cisternë MAN</td><td>1</td><td>1986</td></tr> <tr><td>Mini autofshisa</td><td>1</td><td>2011</td></tr> <tr><td>Kontenjer 1.1 m³</td><td>160</td><td></td></tr> <tr><td>Kontenjer 5 m³</td><td>20</td><td></td></tr> <tr><td>Kontenjer 7 m³</td><td>25</td><td></td></tr> </tbody> </table>	Pajisjet	Sasia/copë	Viti i prodhimit	Kompaktor IVECO	2	2001	Minikomptaktor Mitsubishi	1	2009	Minikomptaktor Mitsubishi	1	2010	Minikomptaktor Mitsubishi	1	2014	Kamiona transportues SKANI P3	1	1990	Kamiona transportues IVECO	1	2001	Kamion kiper 8 t Mercedes 2222	1	1985	Kamion kiper 11 t Mercedes 1717	1	1981	Kamion UNIMAG	1	1987	Traktor IMT 539	4	2001	Lugë ngarkuese ULT 160C	1	1987	Auto Cisternë MAN	1	1986	Mini autofshisa	1	2011	Kontenjer 1.1 m³	160		Kontenjer 5 m³	20		Kontenjer 7 m³	25		<ul style="list-style-type: none"> <li>Pajisjet prishen shpesh kështu që shërbimi i grumbullimit nuk është i saktë.</li> <li>Shumica e kontejnerëve komunal të vendosur në qytet janë të dëmtuar dhe nuk kanë mirëmbajtje.</li> </ul>
Pajisjet	Sasia/copë	Viti i prodhimit																																																			
Kompaktor IVECO	2	2001																																																			
Minikomptaktor Mitsubishi	1	2009																																																			
Minikomptaktor Mitsubishi	1	2010																																																			
Minikomptaktor Mitsubishi	1	2014																																																			
Kamiona transportues SKANI P3	1	1990																																																			
Kamiona transportues IVECO	1	2001																																																			
Kamion kiper 8 t Mercedes 2222	1	1985																																																			
Kamion kiper 11 t Mercedes 1717	1	1981																																																			
Kamion UNIMAG	1	1987																																																			
Traktor IMT 539	4	2001																																																			
Lugë ngarkuese ULT 160C	1	1987																																																			
Auto Cisternë MAN	1	1986																																																			
Mini autofshisa	1	2011																																																			
Kontenjer 1.1 m³	160																																																				
Kontenjer 5 m³	20																																																				
Kontenjer 7 m³	25																																																				
2. Sistemi Institucional																																																					
2.1 Ligjet & rregulloret	<p>1. Niveli Qendror</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ligji mbi mbeturinat ka hyrë në fuqi në Qershor 2012.</li> <li>Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2021, viti 2012.</li> </ul> <p>2. Komuna e Vushtrrisë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Rregullorja për Shërbimeve Publike Komunale (Qershor 2013)</li> <li>Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2014-2019 ( 2013)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Strategjia kombëtare për mbeturina e aprovuar.</li> <li>Në sistemin aktual ligjor, detyrat dhe përgjegjësitë e shkarkimit final janë të qarta.</li> </ul>																																																			
2.2 Administrata & sistemi i menaxhimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Komuna kontrollon vetëm pastrimin publik.</li> <li>Drejtoria e Shërbimeve publike është përgjegjëse për pastrimin e hapësirave publike por aktualisht nuk kanë një organizim të veçantë për menaxhimin e mbeturinave.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shumë përgjegjësi mbi menaxhimin e mbeturina tashmë e janë bërë të qarta.</li> </ul>																																																			
2.3 Gjendja financiare	<p>1. Buxheti i Komunës së Vushtrrisë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Më shumë se 85% e buxhetit komunal është grant nga Qeveria e Kosovës.</li> <li>Komuna aktualisht nuk ka mjete të planifikuara të buxhetit për menaxhimin e mbeturinave.</li> </ul> <p>Buxheti Komunal në vitet 2014 dhe 2015 (njësi: €1,000)</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Pikat</th> <th>2014</th> <th>2015</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>Buxheti i përgjithshëm komunal</td><td>15,472</td><td>15,535</td></tr> <tr><td>Të hyrat vetanake</td><td>2,069 (13%)</td><td>2,168(14%)</td></tr> <tr><td>Granti nga qeveria qendrore dhe donatorët</td><td>13,403 (87%)</td><td>13,366 (86%)</td></tr> <tr><td>Drejtoria e Shërbimeve Publike</td><td>1,408 (9%)</td><td>1,295 (8.33%)</td></tr> <tr><td>Pastrimi i hapësirave publike</td><td>67,670</td><td>67,670</td></tr> <tr><td>Buxheti komunal për kokë banori</td><td>208 €/person</td><td>205 €/person</td></tr> </tbody> </table> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ofruesit e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave deri më tani nuk kanë ndonjë mekanizëm për të detyruar qytetarët të paguajnë për shërbimet.</li> </ul> <p>Sasia e mbeturinave të deponuara është 13,204 t/vit, ndërsa inkasimi është rreth 64% e shërbimit të ofruar.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Pikat</th> <th>Njësi</th> <th>Shuma</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>Buxheti për njësinë e Vushtrrisë</td><td>€</td><td>369,654.</td></tr> <tr><td>Pagesa e mbledhur e mbeturinave</td><td>€</td><td>239,534 apo (64%)</td></tr> <tr><td>Pagesa e kontratave për pastrimin e hapësirave publike</td><td>€</td><td>67,660</td></tr> <tr><td>Sasia e mbeturinave të grumbulluara</td><td>ton/vit</td><td>13,204</td></tr> <tr><td>Kostoja e grumbullimit/njësi</td><td>€/ton</td><td>27.99</td></tr> <tr><td>Pagesa e deponimit</td><td>€/ton</td><td>6.10</td></tr> </tbody> </table>	Pikat	2014	2015	Buxheti i përgjithshëm komunal	15,472	15,535	Të hyrat vetanake	2,069 (13%)	2,168(14%)	Granti nga qeveria qendrore dhe donatorët	13,403 (87%)	13,366 (86%)	Drejtoria e Shërbimeve Publike	1,408 (9%)	1,295 (8.33%)	Pastrimi i hapësirave publike	67,670	67,670	Buxheti komunal për kokë banori	208 €/person	205 €/person	Pikat	Njësi	Shuma	Buxheti për njësinë e Vushtrrisë	€	369,654.	Pagesa e mbledhur e mbeturinave	€	239,534 apo (64%)	Pagesa e kontratave për pastrimin e hapësirave publike	€	67,660	Sasia e mbeturinave të grumbulluara	ton/vit	13,204	Kostoja e grumbullimit/njësi	€/ton	27.99	Pagesa e deponimit	€/ton	6.10	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të hyrat komunale janë të limituara saçë edhe Buxheti për menaxhimin e mbeturinave është limituar po ashtu.</li> <li>Pasi që një numër i qytetarëve nuk paguajnë shërbimin e mbeturinave, shpesh mungojnë mjetet për shpenzimet e nevojshme për grumbullim.</li> <li>Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave nuk është i mjaftueshëm për shkak të mungesave të shpeshta të mjeteve.</li> </ul>									
Pikat	2014	2015																																																			
Buxheti i përgjithshëm komunal	15,472	15,535																																																			
Të hyrat vetanake	2,069 (13%)	2,168(14%)																																																			
Granti nga qeveria qendrore dhe donatorët	13,403 (87%)	13,366 (86%)																																																			
Drejtoria e Shërbimeve Publike	1,408 (9%)	1,295 (8.33%)																																																			
Pastrimi i hapësirave publike	67,670	67,670																																																			
Buxheti komunal për kokë banori	208 €/person	205 €/person																																																			
Pikat	Njësi	Shuma																																																			
Buxheti për njësinë e Vushtrrisë	€	369,654.																																																			
Pagesa e mbledhur e mbeturinave	€	239,534 apo (64%)																																																			
Pagesa e kontratave për pastrimin e hapësirave publike	€	67,660																																																			
Sasia e mbeturinave të grumbulluara	ton/vit	13,204																																																			
Kostoja e grumbullimit/njësi	€/ton	27.99																																																			
Pagesa e deponimit	€/ton	6.10																																																			

<p>2.4 Edukimi Publik dhe bashkëpunimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Disa ngjarje mjedisore shënohen brenda vitit, p.sh. Dita e Tokës (Prill), Ta pastrojmë Kosovën' (Maj).</li> <li>• Zbukurimi i qytetit (mirëmbajtja e oazave të gjelbëruara etj. mbjellja e drunjve dhe luleve)</li> <li>• Në nivel kombëtar, me 2008 është adoptuar strategjia ndër-ministore për Shëndetin publik –nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.</li> <li>• Në strategji, një set materialesh të edukimit mjedisor (përgatitur nga REC) është shpërndarë për të gjitha shkollat fillore publike në Kosovë dhe një mësimdhënës në secilën shkollë është trajnuar me ato materiale.</li> <li>• Tekstet shkollore të shkollës së mesme kanë disa përmbajtje rreth "çështjeve mjedisore" në lëndën e studimeve mjedisore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitetet e zbukurimeve nuk lidhen direkt me grumbullimin ditor të mbeturinave.</li> <li>• Parandalimi i hedhjes ilegale nuk ka qenë temë e programit të vetëdijesimit.</li> <li>• Mënyra e shkarkimit ditor nuk ka qenë temë e programit mjedisor.</li> <li>• Aktivitetet shkollore me bazë mjedisore nuk implementohen në atë mënyrë që të korrespondojnë me shërbimet e ofruara në qytet.</li> <li>• Shkollat janë me shumë mbeturina të shpërndara në oborret e tyre.</li> <li>• Jo shumë njerëz janë të vetëdijshëm me përfitimet e ndarjes dhe Riciklimit të mbeturinave.</li> </ul>
--	---	---

## KAPITULLI IV

### 4 Plani Lokal i Menaxhimit të Mbeturinave

#### 4.1. Supozimet për Planifikim

##### 4.1.1. Shkalla e rritjes së Popullsisë dhe ngritjes ekonomike

###### a. Shkalla e rritjes së popullsisë

Rritja e popullsisë gjerë më 2020 është vlerësuar bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 dhe duke përdorur rritjen e popullsisë të parashikuar në Planin Zhvillimor: Plani Zhvillimor i Komunës së Vushtrisë 2009-2014 ka qenë i aprovuar nga Komuna e Vushtrisë, ndërsa tani është duke u bërë revidimi i tij.

2011 – 2015: 2.148%

2016 – 2020: 2.058%

Bazuar në shkallën e rritjes si më lartë, popullsia në të ardhmen parashikohet si më poshtë.

Tabela 1: Parashikimi i Popullsisë

Viti	Total	Urbane	Rurale
2011	69,870	26,964	42,906
2012	71,267	28,053	43,764
2013	72,692	74,146	44,639
2014	74,146	28,614	45,532
2015	75,629	29,186	46,443
2016	77,141	29,770	47,371
2017	78,684	30,365	48,319
2018	80,258	30,972	49,286
2019	81,863	31,591	50,272
2020	83,500	32,223	51,277

###### b. Shkalla e rritjes së BPV-së

BPV (*Bruto Produkti Vendor*) për kokë banori me 2011 është vlerësuar si USD\$2,750 nga *Fondi Monetar Ndërkombëtar* (FMN) dhe USD3,750 nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Kosovës. Banka botërore (BB) ka vlerësuar BPV-së për kokë banori më 2007 në €1,850, në këtë plan adoptohet vlerësimi i FMN-së me 2011 për kokë banori.

Tabela 2: BPV për kokë banori

	FMN	BB	MEF e Kosovës
BPV për kokë banori me 2011	USD\$2,750	€1,850 in 2007	USD\$3,750
Shkalla e rritjes me 2011	4.4%	5.4%(1999-2009)	4.8%

FMN: Fondi Monetar Ndërkombëtar

BB: Banka Botërore

MEF: Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Republika e Kosovës

Pasi që nuk ka ndonjë vlerë të parashikuar afatgjate për shkallën e rritjes, vlerat e mëposhtme janë adaptuar për këtë projekt, duke iu referuar vlerave të parashikuara nga secila organizatë siç tregohet në Tabela 3.

2011 – 2015: 4.8%

2016 – 2020: 4.4%

Tabela 3: Shkalla e rritjes Ekonomike vlerësuar nga FMN, B/B dhe MEF

Viti	FMN		BB		MEF e Kosovës
	Boterore	Euro zone	Boterore	Euro zone	
2010	5.0%	1.7%	3.8%	1.7%	-
2011	4.4%	1.6%	2.2%	1.7%	-
2012	4.5%	1.8%	3.6%	1.8%	4.8%
2013	-	-	3.6%	1.9%	-

#### 4.1.2. Sasia dhe përbërja e mbeturinave në të ardhmen

##### a. Sasia e mbeturinave të gjeneruara

Formula e parashikimit:

*Sasia e mbeturinave të gjeneruara* në të ardhmen (SMGJ) kalkulohet duke shumëzuar *numrin e burimeve gjeneruese* (NBGJ) dhe *shkallën e gjenerimit të mbeturinave* (SHGJM).

$$SMGJ = SHGJM \times NBGJ$$

##### Numri i Burimeve Gjeneruese të Mbeturinave në të ardhmen (NBGJ):

Numri i burimeve gjeneruese në të ardhmen (NBGJ) për mbeturinat e amvisërisë, që do të thotë popullsisë, parashikohet bazuar në parashikimin e popullsisë sipas (tabela 1). *Numri i burimeve gjeneruese* në të ardhmen (NBGJ) për mbeturinat e shkollës, që llogariten me numrin e nxënësve është relative me numrat e parashikimit të popullsisë. Numri i burimeve gjeneruese në të ardhmen (NBGJ) për një pjesë nga mbeturinat e amvisërisë dhe shkollës, do të rriten me shkallën e rritjes ekonomike.

##### Shkalla e gjenerimit të Mbeturinave në të ardhmen (SHGJ):

*Shkalla e gjenerimit të mbeturinave* në të ardhmen (SHGJ) mendohet të rritet në proporcion me ngritjen ekonomike. Për të parashikuar shkallën e gjenerimit në të ardhmen, është e nevojshme të ekzaminohet marrëdhënia ndërmjet ndryshimeve në GNP (BPV ose GDP) dhe sasisë së mbeturinave të gjeneruara. Statistikat Suedeze (pas 1990, shkalla e gjenerimit ka qenë konstante, rreth 1.1 kg/person/ditë për shkak të promovimit të 3R) që janë regjistruar nga 1963 deri 1988 dhe ka të dhëna të tilla në botë, të cilat tregojnë trendin e rritjes me zhvillimin e ekonomisë si më poshtë:

- Në kohën e ekonomisë në zhvillim (1963-1970):  
Rritja e SHGJ = 55% e shkallës së rritjes së BPV
- Në kohën e ekonomisë së zhvilluar (1975-1988):  
Rritja e SHGJ = 29% e shkallës së rritjes së BPV

Duke marrë parasysh kushtet aktuale në Kosovë, marrëdhënia ndërmjet rritjes së BPV-së së vendit dhe gjenerimit të mbeturinave, mund të supozohet e njëjtë me atë në Suedi në periudhën e ekonomisë në zhvillim. Prandaj, shkalla e gjenerimit të mbeturinave në Kosovë është supozuar të rritet me 55% të shkallës së rritjes së BPV-së.

Veç kësaj, rritja vjetore e shkallës së gjenerimit të mbeturinave e treguar më lartë nuk aplikohet për shërbimet e pastrimit të hapësirave publike (fshirja e rrugëve) por shumat e tyre do të rriten në mënyrë eksplicite në përputhje me rritjen e popullsisë, zgjerimin e qytetit etj. Si pasojë, janë adoptuar vlerësimet e mëposhtme për parashikimin bazuar në statistikat më lartë dhe nga përvojat e mëhershme:

- Shkalla e gjenerimit të hirit dhe mbeturinat nga pastrimi i hapësirave publike nuk do të ndryshojnë në të ardhmen.
- Shkalla e gjenerimit të mbeturinave tjera përveç hirit do të rriten me 2.64 % , (4.8 % x 0.55= 2.64 %) në vit deri me 2020

Tabela 4: Shkalla e gjenerimit të mbeturinave në të ardhmen

Kategoria	Njësi	2015	2017	2019	2020
Amvisëria në urbane	g/person/ditë	521	549	578	609
Amvisëria në rurale	g/person/ditë	535	563	592	623
Restorane	g/restaurant/ditë	4,220	4,442	4,676	4,799
Lokale tjera	g/lokal/ditë	3,250	3,422	3,603	3,698
Pemëtari	g/lokal/ditë	700	737	776	796
Qendra tregtare	g/m <sup>2</sup> /ditë	1200	1263	1324	1359
Zyra	g/zyrë/ditë	400	421	443	455
Shkolla	g/nxënës/ditë	130	130	130	130
Hotele	g/hotel/ditë	100	105	110	113
Tezga tregu	g/tezgë/ditë	1350	1421	1496	1535
Spitali&QKF	kg/spital	1700	1789	1883	1933
Rrugë & Parqe	g/m <sup>2</sup> /ditë	300	316	330	338

Tabela 5: Burimet gjeneruese të mbeturinave në të ardhmen

Kategoria	Njësi	2015	2017	2019	2020
Amvisëria në urbane	person	29,186	30,365	31,591	32,223
Amvisëria në rurale	person	46,443	48,319	50,272	51,277
Restorane	restaurant	455	479	504	517
Lokale tjera	Lokal	1,149	1,209	1,273	1,307
Pemëtari	lokal	197	207	218	224
Qendra tregtare	m <sup>2</sup> (të katit)	13,970	14,708	15,485	15,894
Shkolla	Nxënës	15,657	15,657	15,657	15,657
Hotele	Hotel	4	4	5	5
Tezga tregu	Tezgë	87	92	97	99
Spitale&QKMF	Spital	3	3	3	3
Rrugë & Parqe	m <sup>2</sup>	59,872	63,033	66,361	68,113

Tabela 6: Sasia e gjenerimit të mbeturinave në të ardhmen

Kategoria	Njësi	2015	2017	2019	2020
Amvisëria në urbane	ton/ditë	15.20	16.00	16.84	17.28
Amvisëria në rurale	ton/ditë	24.88	26.19	27.57	28.29
Restorane	ton/ditë	4.22	4.44	4.67	4.79
Lokale tjera	ton/ditë	3.25	3.42	3.60	3.69
Pemëtari	ton/ditë	0.70	0.74	0.78	0.80
Qendra tregtare	ton/ditë	1.20	1.26	1.33	1.36
Zyra	ton/ditë	0.40	0.42	0.64	0.65
Shkolla	ton/ditë	1.30	1.37	1.44	1.48
Hotele	ton/ditë	0.10	0.11	0.12	0.12
Tezga tregu	ton/ditë	1.35	1.42	1.49	1.53
Spitali dhe QKMF	ton/ditë	1.70	1.79	1.88	1.93
Rrugë & Parqe	ton/ditë	0.30	0.32	0.34	0.35
<b>Total</b>	ton/ditë	<b>54.60</b>	<b>57.48</b>	<b>60.05</b>	<b>61.63</b>

#### b. Përbërja e mbeturinave në të ardhmen

Përbërja e mbeturinave në të ardhmen parashikohet duke krahasuar rezultatet e SSPM me të dhënat e mbeturinave nga vendet tjera. Parashikimi në themel bazohet në supozimet e mëposhtme:

- Sasia e gjenerimit të mbeturinave, që përdoren për enët dhe paketimin e mallrave (p.sh. letra, plastika, metali, shishet &xhami) dhe mbeturinat e kuzhinës, supozohet të rriten në përputhshmëri me ngritjen ekonomike. Me këtë, shkalla e gjenerimit të këtyre mbeturinave do të rritet me të njëjtën shkallë të cekur në shkallën e gjenerimit të mbeturinave.
- Sasia e tekstilit të gjeneruar, gomës dhe lëkurës (shkalla e së cilave është shumë e ulët) supozohet të rriten në përputhshmëri me ngritjen ekonomike por më pak se llojet e mbeturinave të cekura më lartë. Prandaj, shkalla e gjenerimit të këtyre mbeturinave do të rritet sa gjysma e asaj të cekur më lartë, për vit.
- Sasia e gjeneruara për barin dhe drurin, qeramikën, gurin, dheun, hirin dhe mbeturinat tjera, supozohet të mos rriten në përputhshmëri me ngritjen ekonomike. Prandaj, nuk do të rritet shkalla e gjenerimit të atyre mbeturinave.

Bazuar në këto supozime, përbërja e mbeturinave në të ardhmen vlerësohet si në tabelën më poshtë:

Tabela 7: Përbërja e mbeturinave në të ardhmen

Përbërja	2015	2017	2019	2020
Mbeturinat e kuzhinës	42.8%	43.22%	43.66%	44.09%
Letra	13.10%	13.25%	13.36%	13.42%
Tekstili	0.95%	0.95%	0.95%	0.95%
Plastika	11.85%	11.96%	12.08%	12.14%
Bari & druri(mbetjet e gjelbërta)	3.50%	3.40%	3.30%	3.20%
Goma dhe lëkura	0.40%	0.40%	0.40%	0.40%
Metali	1.20%	1.21%	1.22%	1.23%
Gjami/shishet	3.60%	3.70%	4.0%	4.2%
Qeramika & guri	0.50%	0.50%	0.50%	0.50%
Hiri/dheu	11.58%	11.02%	10.75%	10.50%
Tjera	10.52%	10.00%	9.76%	9.37%
Totali	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Numri i burimeve gjeneruese në të ardhmen (NBGJ) për mbeturinat e amvisërisë, që do të thotë popullsisë, parashikohet bazuar në parashikimin e popullsisë sipas (tabela 1). *Numri i burimeve gjeneruese* në të ardhmen (NBGJ) për mbeturinat e shkollës, që llogariten me numrin e nxënësve është relative me numrat e parashikimit të popullsisë. Numri i burimeve gjeneruese në të ardhmen (NBGJ) për një pjesë nga mbeturinat e amvisërisë dhe shkollës, do të rriten me shkallën e rritjes ekonomike.

#### 4.1.3 Rrjedha e mbeturinave në të ardhmen, pa planifikim

Shkalla e shkarkimit, grumbullimit; deponimi dhe sasia e hedhjes ilegale është e njëjtë me sasinë e gjeneruar sikur tani.

Gati gjithë mbeturinat e gjeneruara do të shkarkohen pa ndonjë reduktim.

Sidoqoftë, 56.76% e hedhjeve ilegale hiqet, 43.24% do të derdhet dhe shpërndahet brenda zonës komunale. Sasia e akumuluar e mbeturinave në pikat ilegale që nga 2016 deri me 2020 vlerësohet si 12,136 ton.

Tabela 8: Rrjedha e mbeturinave pa planifikim

Pikat	Njësi	2015	2017	2019	2020
Sasia e gjenerimit	ton/ditë	54.60 (100 %)	57.28	60.30	61.89
Sasia e shkarkimit	ton/ditë	36 (65.90%)	37.90	39.90	40.95
Sasia e grumbullimit	ton/ditë	33.16 (60.73%)	34.90	36.74	37.70
Sasia e deponimit	ton/ditë	36 (60.73%)	37.90	39.90	40.95
Hedhja ilegale	ton/ditë	15.38 (28.19%)	16.19	16.23	16.65
Mbeturinat e mbetura	ton/ditë	9.39 (17.2%)	9.88	10.14	10.40



## 4.2 Politika bazë

“Krijimi i një ambienti të pastër dhe të shëndoshë në Vushtrri deri më 2020”

Themelimi i një sistemi të tillë do të ndikojë në:

- Mirëmbajtjen e mjedisit urban dhe shëndetin publik në Komunën e Vushtrrisë, që është vendlindja e vushtrriasve dhe kontributin për një zhvillim të qëndrueshëm të qytetit.
- Motivimin e investimeve, ku do të promovohet zhvillimi ekonomik i regjionit verior të Kosovës.

Në një sistem të shëndoshë mjedisor të menaxhimit të mbeturinave, promovohet 3R (**R**eduktimi, **R**i-përdorimi dhe **R**i-ciklimi) i mbeturinave, përmes së cilit zgjidhen problemet si më poshtë.

-Inkurajohet reduktimi i mbeturinave të burimi gjenerues, si të amvisëritë ashtu edhe të bizneset afariste.

-Mbeturinave të gjeneruara pas Reduktimit, Ri-përdorimit ose Riciklimit të jenë sa më të pakta, aq sa ka mundësi.

-Vetëm pas përpjekjeve për reduktimin, ri-përdorimin ose riciklimin e mbeturinave, mbeturinat grumbullohen, trajtohen dhe më në fund deponohen në një mënyrë të duhur pa ndonjë efekt negativ mjedisor.

-Një sistem i tillë i menaxhimit të mbeturinave, do të themelohet duke kërkuar nga qeveria komunale, sektori privat dhe komuniteti në përgjithësi të bartin përgjegjësitë në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme.

## 4.3 Viti i Synuar

Vizioni i lartpërmendur do të arrihet hap pas hapi. Viti i synuar i Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë, përfshinë periudhën pesëvjeçare 2016 deri 2020.

Ky plan pesëvjeçar i menaxhimit të mbeturinave është bërë me qëllim të përputhjes me periudhat prej 2016 deri 2020 të planit kombëtar për menaxhimin e mbeturinave dhe ndahet në dy faza:

Faza e 1<sup>re</sup> : 2016 – 2018 Krijimi i sistemit të ri të grumbullimit

Faza e 2<sup>të</sup> : 2018 – 2020 Krijimi i një sistemi të shëndoshë të menaxhimit të mbeturinave

Prandaj, plani pesë vjeçar i menaxhimit të mbetjeve duhet të modifikohet deri në fund të vitit 2020, bazuar në progresin e performancës së fazës së parë.

## 4.4 Synimi Numerik

Pikat	2015	2017	2019	2020
Shkalla e mbulueshmërisë së shërbimit të grumbullimit <sup>*1</sup>	43.49%	85.0%	95.0%	100.0%
Shkalla e grumbullimit <sup>*2</sup>	60.73%	70.94%	80.32%	95.10%
Shkalla e hedhjes ilegale <sup>*3</sup>	28.19%	15.40%	6.70%	0.0%
Shkalla e deponimit final <sup>*4</sup>	65.9%	85.70%	84.0%	82.60%
Shkalla e Riciklimit <sup>*5</sup>	3.29%	5.10%	9.30%	17.40%

\*1: Shkalla e mbulueshmërisë së shërbimit të grumbullimit do të thotë shkalla e popullsisë së shërbyer mepopullsinë e përgjithshme.

\*2: Shkalla e grumbullimit do të thotë shkalla e sasisë së mbeturinave të grumbulluara me sasinë e përgjithshme të gjeneruar.

\*3: Shkalla e hedhjes ilegale do të thotë shkalla e mbeturinave të hedhura ilegalisht duke përfshirë hedhjen jo të duhur brenda zones pa shërbim me sasinë e përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara.

\*4: Shkalla e deponimit final do të thotë shkalla e mbeturinave të deponuara në deponitë e licencuara dhe ato të pa licencuara (hedhja ilegale) me sasinë e përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara.

\*5: Shkalla e Riciklimit do të thotë sasia e mbeturinave të ricikluara me sasinë e përgjithshme të gjeneruar.

## 4.5 Strategjia

### 4.5.1 Mënyra e menaxhimit të mbeturinave

#### a. Sistemi i grumbullimit të mbeturinave

Komuna e Vushtrrisë do të menaxhoj mbeturinat konform Ligjit në fuqi për mbeturinat. Prandaj, Komuna e Vushtrrisë shfuqizon sistemin e grumbullimit të mbeturinave i cili është menaxhuar nga KRM „Uniteti” ku ata kanë ofruar shërbimin e grumbullimit të mbeturinave dhe kanë bërë inkasimin në mënyrë të pavarur.

Komuna do të sigurojë buxhetin e nevojshëm përmes ‘taksës për mbeturina’ e cila do të mblidhet nga qytetarët dhe bizneset të cilat shkarkojnë mbeturinat e tyre bashkë me mbeturinat e amvisërisë dhe në mënyrë të drejtë do tua besojë këtë kompanive për grumbullim dhe transportim të mbeturinave komunale, të licencuara nga MMPH.

Sistemi i ri i grumbullimit të mbeturinave është përshkruar në figurë. Bizneset e shkallës së lartë të cilat shkarkojnë sasi të mëdha të mbeturinave duhet të shërbehen nga ofruesi i shërbimit duke kontraktuar shërbimet individualisht.

Figura 3: Përshkrimi i Sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Vushtri




Figura 3: Përshkrimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Vushtri

Ofruesit e Shërbimeve të cilët Komuna e Vushtrrisë dhe bizneset e mëdha afariste i kontraktojnë, duhet të jenë të licencuar nga MMPH për të trajtuar mbeturinat komunale. Prandaj, secili ofrues i shërbimeve i cili trajton mbeturinat duhet të ketë miratimin nga Qeveria.

#### **b. Sistemi i menaxhimit të grumbullimit të mbeturinave**

Pasi që është e domosdoshme që shërbimi i grumbullimit të mbeturinave të bëhet në bashkëpunim me komunën, ofruesit e shërbimeve dhe qytetarët, Komuna e Vushtrrisë do të kërkojë nga qytetarët bashkëpunim për të bërë shkarkimin e mbeturinave sipas rregullave dhe të obligojë ofruesin e shërbimeve të trajtojë punëtorët e grumbullimit për të përmirësuar edhe mënyrën e punës.

Komuna e Vushtrrisë pranon edhe ankesat të cilat i analizon, pastaj e udhëzon dhe obligon ofruesin e shërbimeve për të marrë masat e përshtatshme në ngritjen e kualitetit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

#### **c. Kontraktimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave**

Sipas planit për menaxhimin e mbeturinave, Komuna e Vushtrrisë kontraktkon shërbimin e grumbullimit me KRM „Uniteti” dhe kompanitë private (sipas nevojës).

Komuna e Vushtrrisë do të organizoj një tender për zgjedhës konkurrent çdo dhjetor ku bënë për zgjedhjen e ofruesit për vitin në vijim. Zona e shërbimit për tu caktuar te konkurenti tenderues, vendoset duke marrë parasysh performancën aktuale të vitit paraprak dhe kapacitetit të tij.

Prandaj, Komuna e Vushtrrisë është e obliguar që të bëjë kontraktimin e kompanisë e cila ka një licencë për trajtimin e mbeturinave komunale të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

#### **d. Taksa për mbeturina**

Kompania e grumbullimit të mbeturinave ka ofruar shërbimin e grumbullimit dhe kanë bërë inkasimin për shërbimin e grumbullimit deri ne fund të vitit 2014 dhe gjatë vitit 2015. Por inkasimi nuk ka arritur një shkallë të mjaftueshme dhe për këtë edhe shërbimi nuk ka qenë i kënaqshëm.

Prandaj, Komuna e Vushtrrisë ka vendosur të prezantojë “taksën për mbeturina”, ta mbledh atë nga gjithë qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejte, të ofrojë shërbim të duhur për qytetarët duke eliminuar zonat pa shërbim si dhe hedhjet ilegale.

#### 4.5.2 Strategjia për të arritur synimin

Për të arritur këtë synim Komuna e Vushtrrisë do të veprojë sipas strategjisë së mëposhtme:

Pikat	Aktivitetet
Faza e parë (2016 – 2018)	
Aspekti teknik	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të eliminohen zonat pa shërbim të grumbullimit të mbeturinave</li> <li>• Të eliminojë mbeturinat e mbetura</li> <li>• Të eliminojë mbeturinat e shpërndara rreth kontejnerëve komunal</li> <li>• Të pakësoj hedhjet ilegale deri në gjysmën e vitit 2016</li> </ul>
T1: Ruajtja & shkarkimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të standardizojë metodën e shkarkimit të mbeturinave (zhvilloj rregullat e shkarkimit)</li> <li>• Të promovojë rregullat e shkarkimit</li> <li>• Të promovojë kompostimin shtëpiak</li> </ul>
T2: Grumbullimi & transportimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të zgjeroj shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në zonat pa shërbim</li> <li>• Të përmirësoj sistemin e grumbullimit të mbeturinave duke përshtatur me karakteristikat e zonës (grumbullim derë më derë, skaj rrugës, grumbullimi me kabanë, grumbullimi me kontejnerë, etj.)</li> <li>• Të kryejë grumbullim të rregullt sipas rregullave të shkarkimit</li> <li>• Të kryejë grumbullimin e mbeturinave me saktësi në përputhje me promovimin e rregullave të shkarkimit</li> <li>• Të trajnohen punëtorët e grumbullimit dhe vozitësit me mënyrën e grumbullimit</li> </ul>
T3: Pastrimi i hapësirave publike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të vazhdohet me sistemin aktual të implementimit të mirëmbajtjes dhe pastrimit</li> <li>• Të vetëdijësohen qytetarët mbi parandalimin e rrjedhjes së mbeturinave</li> <li>• Përgatitja e Prezantimit të "Programit të Adoptimit"</li> </ul>
T4: Deponimi Final	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të monitorojë kapacitetin e mbetur të deponisë së Gërmovës dhe ti kërkohet KRM Uniteti, menaxhimi i qëndrueshëm i deponisë.</li> <li>• Të kërkohet monitorimi i kualitetit të ujit me qëllim të minimizimit të ndikimeve mjedisore të rrethinës.</li> </ul>
T5: Riciklimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 10% e amvisërisë në zona rurale të ndajë mbetjet nga kuzhina dhe ti kompostojë ato deri me 2017.</li> <li>• Komposti shtëpiak në zona urbane do të prezantohet në bazë prove deri me 2017.</li> <li>• Të ekzaminojë masat mbështetëse të marra nga qeveria për grumbullimin e gjërave të riciklueshme të kryera nga ndërmarrja sociale për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme dhe nga sektori privat.</li> <li>• Të ekzaminohet kompostimi i mbeturinave nga tregu.</li> <li>• Të përkrahet grumbullimi ndaras i gjërave të riciklueshme të kryera nga sektori privat nga kontraktorët e grumbullimit të mbeturinave.</li> </ul>
T6: Mirëmbajtja e pajisjeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të obligohen ofruesit e shërbimeve të grumbullimit që të dorëzojnë planin e mirëmbajtjes së pajisjeve dhe planin e operimit</li> </ul>

Mbeturinat Industriale	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përgatisë planin e menaxhimit të mbetjeve industriale konform ligjit të ri mbi mbeturinat.</li> <li>• Të ndahen mbeturinat e rrezikshme nga mbeturinat komunale në pikën e shkarkimit në mënyrë strikte</li> <li>• Të monitorohet se mbeturinat e rrezikshme trajtohen dhe/ose ruhen si duhet</li> </ul>
Aspekti Institucional	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Themelimi i sistemit institucional në menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë</li> <li>• Themelimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar të MM</li> <li>• Të krijojë sistemin e menaxhimit të mbeturinave në Komunë <ul style="list-style-type: none"> <li>· Sistemin e planifikimit, sistemin e udhëheqjes (inspektimin), sistemin e menaxhimit të të dhënave, etj.</li> </ul> </li> </ul>
I1: Aranzhimet Juridike	<p>Komuna e Vushtrrisë</p> <p>Të amandamentojë vendimet dhe rregulloret në përputhje me ligjin e ri mbi mbeturinat.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përgatisë planin vjetor të veprimit në përputhje me planin për menaxhimin e mbeturinave.</li> </ul>
I2: Administrata & manaxhmenti	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të fuqizojë sektorin e menaxhimit të mbeturinave brenda drejtorisë për shërbime publike, për të themeluar një sistem të duhur të menaxhimit të mbeturinave.</li> <li>• Të sigurojë numrin e nevojshëm të personave të aftë për sektorin për menaxhim të mbeturinave dhe të fuqizojnë kapacitetet përmes trajnimeve dhe aktiviteteve tjera</li> <li>• Të pranojë ankesat për mbeturinat dhe të ju përgjigjet atyre.</li> <li>• Të marrin pjesë në fuqizimin e Kompanisë Uniteti Njësia punuese në Vushtri në mënyrë që të implementohet plani për menaxhimin e mbeturinave sa më lehtë.</li> </ul>
I3: Edukimi Publik	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të organizohet komuniteti përmes promovimit të aktivitetit "Rruga Ime"</li> <li>• Të inkurajohen banorët lokal që të ruajnë mbeturinat e tyre brenda oborrit të tyre</li> <li>• Të shpërndahen rregullat e shkarkimit</li> </ul>
I4: Financat	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të sigurojë qëndrueshmëri financiare për kontraktimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave bazuar në sistemin e taksës për mbeturina.</li> <li>• Të fuqizojë aktivitetet në ngritjen e vetëdijesimit publik për të ngritur shkallën e grumbullimit të taksës për mbeturina.</li> </ul>
I5: Zhvillimi i kapaciteteve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të fuqizohen njohuritë dhe aftësitë e stafit të KP përmes trajnimeve</li> <li>• Të rritet numri i stafit të Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave në bashkëpunim me MMPH dhe Ministrinë e Administratës Publike.</li> </ul>
Faza e dytë (2016 – 2018)	
Aspektet teknike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të eliminojë hedhjet ilegale deri 2020</li> <li>• Të promovojë minimizimin e mbeturinave përmes aktiviteteve 3R</li> </ul>
T1: Ruajtja & shkarkimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të promovojë rregullat e shkarkimit për qytetarët</li> <li>• Të promovojë ndarjen e mbeturinave (të riciklueshmet, mbetjet e kuzhinës) për riciklim</li> </ul>

T2: Grumbullimi & transportimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të vazhdohet me grumbullimin e rregullt</li> <li>• Të vazhdohet me një qasje të mirë të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave</li> </ul>
T3: Pastrimi i hapësirave publike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të promovohet "program i adoptimit"</li> <li>• Të vazhdojë me pastrimin e hapësirave publike sikur deri më tani</li> </ul>
T5: Deponimi final	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të vazhdojë monitorimin e kualitetit të ujit</li> <li>• Të fillon studimi i mundësive të zgjerimit të kapacitete të deponisë</li> </ul>
Promovimi i Riciklimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të filloj me kompostimin e mbeturinave nga tregu nga ana e sektorit privat</li> <li>• Të përkrah ndarjen e gjërave të riciklueshme të kryera ndërmarrja për riciklim si dhe nga kompanitë private ofruesit e shërbimit të grumbullimit, etj.</li> <li>• Të fuqizojë dhe bëjë aktivitete vetëdijesimi me qytetarët</li> <li>• Të ricikloje mbeturinat organike <ul style="list-style-type: none"> <li>· 10.0% e mbeturinave organike në zonat urbane të ndahen deri me 2020.(aktualisht 0.0%)</li> <li>· 20.0% e mbeturinave të kuzhinës në zona rurale të ndahet deri me 2020 (aktualisht 1.0%)</li> <li>· Mbeturinat e tregut do të ndahen nga 2015 dhe 40% e saj do të kompostohet deri me 2020 (aktualisht 0.0%)</li> </ul> </li> <li>• Të grumbullohen gjërat e riciklueshme <ul style="list-style-type: none"> <li>· 90% e metalit të grumbullohet deri me 2020 (aktualisht 62.1%)</li> <li>· 60% e letrës të grumbullohet deri me 2020 (aktualisht 18.7%)</li> <li>· 50% e plastikës të grumbullohet deri me 2020 (aktualisht 13.0%)</li> <li>· 40% e shisheve/gjamit të grumbullohet deri me 2020 (aktualisht 7.8%)</li> </ul> </li> </ul>
Aspekti Institucional	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Komuna e Vushtrrisë vazhdon implementimin e planit për menaxhimin e mbeturinave.</li> </ul>
I1: Aranzhimet juridike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përgatitet plani i veprimit për çdo vit, bazuar në planin pesë-vjeçar të menaxhimit të mbeturinave.</li> <li>• Të hartohet drafti i dytë pesë vjeçar deri në fund të vitit 2020 dhe të filloj së aplikuari deri në fillim të vitit 2021.</li> </ul>
I2: Administrata& menaxhmenti	<ul style="list-style-type: none"> <li>• SMM kryen aktivitete të menaxhimit të mbeturinave në Komuna e Vushtrrisë</li> </ul>
I3: Financat	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkalla e grumbullimit të pagesës së mbeturinave duhet të arrijë 90%, plani 5 vjeçar i menaxhimit të mbeturinave realizohet sipas planit..</li> </ul>
I4: Zhvillimi i kapaciteteve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Stafit i SMM do të ndajë me komunat tjera përvojat e tyre dhe njohuritë e fituara përmes implementimit të këtij plani.</li> <li>• Një qasje e mirë e stafit të Unitetit do të ishte një shembull i mirë për kompanitë tjera të mbeturinave.</li> </ul>

#### 4.6 Rrjedha e mbeturinave në të ardhmen

Kur të gjitha aktivitetet të jenë implementuar sipas orarit dhe strategjisë së përmendur më lartë, rrjedha e mbeturinave do të ishte si më poshtë:

Tabela 9: Rrjedha e Mbeturinave

	Njësi	2015	2016	2017	2018	2019
Gjenerimi	ton/ditë	54.6	56.04	57.52	59.00	60.55
Mbeturinat e amvisërisë	ton/ditë	31.90	32.74	33.60	34.49	35.40
Mbeturinat e biznesit	ton/ditë	21.50	22.06	22.64	23.24	23.85
Mbeturinat nga hapësirat publike	ton/ditë	1.20	1.26	1.29	1.32	1.35
Grumbullimi komunal	ton/ditë	33.16	34.03	34.92	35.84	36.79
Hedhjet ilegale	ton/ditë	15.38	15.79	16.21	16.64	17.08
Heqja e hedhjeve ilegale	ton/ditë	8.73	8.93	9.17	9.41	9.66

## KAPITULLI V

### 5. Plani i implementimit

#### 5.1 Aktivitetet prioritare

Për të arritur synimin nga strategjia, Komuna e Vushtrrisë implementon prioritetet bazë si më poshtë.

a. Fuqizimi i sistemit teknik

1. Përmirësimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave
2. Promovimi i minimizimit të mbeturinave

b. Fuqizimi i sistemit institucional

- (1) Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë
- (2) Krijimi i sistemit financiar për MM
- (3) Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave
- (4) Promovimi i minimizimit të mbeturinave
- (5) Përkrahje për ri-organizimin e komunitetit

#### 5.1.1 Fuqizimi i sistemit teknik

##### a. Përmirësimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave

##### a.1. Krijimi i sistemit të monitorimit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave

Janë tri lloje të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave komunale në Vushtri siç edhe paraqiten në tabelën më poshtë. Grumbullimi i mbeturinave komunale i shkarkuar nga amvisëritë dhe bizneset afariste kontraktohet me kompaninë UNITETI si dhe me kompanitë që posedojnë licencë nga MMPH, që nga Janari 2016. Pastrimi i hapësirave publike siç janë rrugët, parqet dhe heqja e borës kontraktohen në bazë të procedurave të tenderimit. Komuna e Vushtrrisë do të prezantojë edhe shërbimin e grumbullimit të mbeturinave me përmasa të mëdha ku detajet përmenden në a.4.

Komuna e Vushtrrisë udhëheq shërbimet e pastrimit publik për tu siguruar se ato punë kryhen si duhet. Në të njëjtën kohë vendos edhe kutinë e ankesave në vende të caktuara komunale ku edhe krijon sistemin e kontrollit të shërbimeve për të marrë këndvështrimet nga të dy palët, qeveria komunale dhe qytetari.

Tabela 10: Ofruesit e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave komunale

Pastrimi Publik	Ofruesi aktual i shërbimeve	Ofruesi i propozuar i shërbimeve
1. Grumbullimi i përgjithshëm i mbeturinave	KRM Uniteti, Kompanitë Private	Uniteti dhe kompanitë private të kontraktuara nga DSHP
2. Grumbullimi i mbeturinave me përmasa të mëdha	KRM Uniteti, Kompanitë Private	Uniteti dhe kompanitë tjera kontraktuese në bazë kërkesë kundrejt pagesës
3. Pastrimi i hapësirave publike	Uniteti, Kompanitë Private	Uniteti dhe kompanitë private

DSHP: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komuna e Vushtrrisë

## **a.2. Aplikimi i sistemit të grumbullimit me kabanë**

Komuna e Vushtrrisë do të aplikojë sistemin e grumbullimit në zonat rezidenciale, sipas praktikave të qëndrueshme, prandaj obligon ofruesin e shërbimit të instalojë kabanën. Edhe pse po ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave, ende në zonën komunale ka pika ilegale të mbeturinave. Por pritet që me bashkëpunimin e qytetarëve të cilët pranojnë shërbimet nga ofruesi, të përkrahët grumbullimi me kabanë. Komuna e Vushtrrisë do të vazhdojë me edukim publik ku do të shpalos edhe informata mbi mënyrën e shkarkimit dhe të promovojë menaxhimin e mbeturinave me pjesëmarrje të komunitetit.

## **a.2 Eliminimi i zonave pa shërbim të grumbullimit të mbeturinave**

Në zonat ku nuk ofrohet shërbimi, komuna do të zgjerojë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave për të arritur synimin e këtij plani dhe deri në vitin 2020 të eliminojë të gjitha zonat pa shërbim.

## **a.3 Prezantimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave me përmasa të mëdha**

Deri në vitin 2015 në Vushtri nuk ka një sistem të grumbullimit të mbeturinave me përmasa të mëdha. Mbeturinat si mobilet, tepihët e të tjerat janë shkarkuar si mbeturina të amvisërisë, të cilat janë bërë pengesë për grumbullimin e mbeturinave komunale. Prandaj, Komuna e Vushtrrisë ka vendosur që të prezantojë grumbullimin e mbeturinave me përmasa të mëdha në bazë të kërkesës individuale nga qytetari. Ofruesi i shërbimit për mbeturina me përmasa të mëdha do të jetë i njëjti i cili është i kontraktuar nga Komuna e Vushtrrisë për grumbullimin e mbeturinave në zonën e caktuar.

## **b. Promovimi i minimizimit të mbeturinave**

Mbeturinat e kuzhinës të cilat llogariten të jenë 58,42 % e mbeturinave komunale mund të shkaktojnë problem të gjenerimit të gazrave të metanit të cilat janë gazra shumë efektive të ngrohjes globale dhe rrjedhjeve. Kështu që promovimi i kompostimit të mbeturinave të kuzhinës te burimi gjenerues pritet të jetë efikas në pakësimin e vëllimit të mbeturinave dhe zgjatjes së jetës së deponisë dhe në të njëjtën kohë edhe reduktimin e veprimit negativ në mjedis. Për të arritur këtë qëllim, Komuna e Vushtrrisë prezanton një sistem për prokurimin e enës kompostuese shtëpiake.

Komuna e Vushtrrisë synon ndarjen e enëve kompostuese 20 % të amvisërive në zona rurale dhe 10 % në zona urbane deri në vitin 2020. Për të fuqizuar aktivitetet, nga qytetarët kërkohet që së bashku me sektorin e menaxhimit të mbeturinave të ideojnë mënyrën e furnizimit dhe blerjes së enëve të kompostimit.



### 5.1.2. Fuqizimi i sistemit institucional

#### a. Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë

Për të realizuar planin për menaxhim të mbeturinave, Komuna e Vushtrrisë fuqizon njësinë e menaxhimit të mbeturinave të themeluar brenda Drejtorisë për Shërbime Publike e cila do ti kryejë këto detyra:

- Përzgjedhja e duhur e ofruesve të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave
- Monitorojë dhe udhëzoj Unitetin dhe kompanitë private për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave,
- Të fuqizojë monitorimin e hedhjeve ilegale
- Të bëjë vetëdijesimin e qytetarëve për shkarkimin e mbeturinave dhe të promovojë pjesëmarrjen publike

#### a.1 Fuqizimi i Sektorit të Menaxhimit të Mbeturinave

Struktura e sektorit të menaxhimit të mbeturinave duhet të themelohet brenda Drejtorisë për Shërbime Publike e cila fuqizohet sipas figurës së shfaqur deri në vitin 2016 dhe krijohet një sistem i cili do të jetë në gjendje të përmbush detyrat dhe përgjegjësitë e Komunës siç edhe e përcakton Ligji i ri mbi mbeturinat.

Struktura do të fuqizohet hap pas hapi dhe numri i stafit do të rritet siç është paraparë në tabelën më poshtë.

Tabela 12: Plani i rritjes së numrit të stafit të Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave

	2015	2016	2017	2018	2019
Shefi i sektorit	1	1	1	1	1
Njësia e Planifikimit	-	1	1	2	2
· Zyrtar (Plani i MM)	-	1	1	1	1
Menaxhimi i të dhënave dhe kontraktimit	-	1	1	1	1
· Arkëtari	-	1	1	1	1
Totali	1	5	5	6	6

#### a.2 Bashkëpunimi me sektorët tjerë

Aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave përbëhen jo vetëm nga menaxhmenti i tenderimit, monitorimit të kualitetit të shërbimit, përgjigja në ankesa të qytetarëve etj., të cilat mund të përkrahen nga sektori i menaxhimit të mbeturinave por edhe nga ngritja e vetëdijesimit publik, të cilat ky sektor nuk mund ti përkrah.

Për këtë arsye, sektori i menaxhimit të mbeturinave duhet të themelojë një sistem të shëndoshë bashkëpunimi edhe me sektorët tjerë relevant siç është sektori për mbrojtjen e mjedisit. Për më shumë, është i domosdoshëm edhe bashkëpunimi me Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financave për të lehtësuar kontraktimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave të mbuluar nga taksa për mbeturina më lehtësisht.

## **b. Krijimi i sistemit financiar për menaxhimin e mbeturinave**

Në mënyrë që pritjet të jenë të kënaqshme për të hyrat nga taksa për mbeturina që është planifikuar të prezantohet nga fundi vitit 2016, është shumë i rëndësishëm themelimi i një sistemi të mirëfilltë të menaxhimit të mbeturinave. Për këtë arsye Komuna e Vushtrrisë duhet të bëjë aktivitete të edukimit publik, për të ngritur vetëdijen e qytetarëve e me këtë edhe për të ngritur shkallën e inkasimit.

Në anën tjetër, menaxhimi i taksës së grumbulluar është shumë i rëndësishëm dhe me këtë do të krijohet një sistem financiar i operuar lehtësisht në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave.

Komuna e Vushtrrisë informon mbi financat përmes faqes zyrtare të komunës dhe formave tjera të ligjshme në mënyrë të rregullt dhe siguron transparencën e cila sjellë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e qytetarëve.

## **c. Krijimi i sistemit të procesit të kontraktimit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave**

Komuna e Vushtrrisë do të përzgjedhë ofruesit e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në pjesën e fundit të çdo viti. Sektori i menaxhimit të mbeturinave duhet të optimizojë procesin e kontraktimit në atë mënyrë që të ndajë zonën e shërbimit për secilin ofrues të shërbimit, vlerëson çmimin e tenderit, cakton specifikacionet e shërbimit, parakualifikon tenderuesit. Prandaj, sektori i menaxhimit të mbeturinave shqyrton procesin pas përzgjedhjes së ofruesve të shërbimit dhe i adreson ato çështje për ta përmirësuar në procesin tjetër.

## **d. Promovimi i minimizimit të mbeturinave**

### **d.1 Sistemi për promovimin e kompostimit shtëpiak**

Komuna e Vushtrrisë do të kontribuojë me pjesëmarrje në koston kur një qytetar e blenë atë, në mënyrë që të promovohet kompostimi.

Komuna e Vushtrrisë subvencionon vetëm atë enë kompostimi të cilin e aprovon për të siguruar kualitetin e enës kompostuese.

### **d.2 Përkrahja e aktiviteteve 3R të kryera nga ofruesi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave**

Komuna e Vushtrrisë ka vendosur që të përfshijë tarifën e deponimit në shumën e kontratës e cila do të marrë pajtimin mes Komunës së Vushtrrisë dhe ofruesit të shërbimeve për promovimin e minimizimit të mbeturinave. Ofruesi i shërbimeve mund të ulë koston e deponimit nëse ka mundësinë të reduktojë mbeturinat e grumbulluara përmes aktiviteteve 3R.

## 5.2.Orari i implementimit

Orari i implementimit të Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave shfaqet në tabelën më poshtë.

Tabela 13: Orari i implementimit

Aktivitetet	2016	2017	2018	2019	2020
<b>1. Përmirësimi i Sistemit teknik</b>					
a. Përmirësimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave					
a.1 Krijimi i sistemit të monitorimit të grumbullimit të mbeturinave	■	■	■	■	■
a.2 Prezantimi i sistemit të grumbullimit me kampanë	■	■			
a.3 Eliminimi i zonave pa shërbim të grumbullimit të mbeturinave	■	■			
a.4 Prezantimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave me përmasa të mëdha	■	■			
<b>2 Fuqizimi i Sistemit institucional</b>					
a. Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Vushtrisë	■	■	■	■	■
a.1 Fuqizimi i Sektorit të menaxhimit të mbeturinave	■	■	■	■	■
a.2 Bashkëpunimi me sektorët tjerë	■	■	■	■	■
b. Krijimi i sistemit financiar për MM	■	■			
c. Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	■	■			
d. Promovimi i minimizimit të mbeturinave					
d.1 Sistemi i promovimit të kompostimit shtëpiak	■	■	■	■	■
d.2 Përkrahja e aktiviteteve të 3R të ndërmarra nga ofruesi i Shërbimit të grumbullimit		■	■	■	■
e. Përkrahja e ri-organizimit të komunitetit	■	■	■	■	■
<b>3 Monitorimi i punëve të grumbullimit dhe zonës së deponimit</b>	■	■	■	■	■

### 5.3 Vlerësimi i kostos

#### 5.3.1. Kushtet për vlerësimin e kostos

Kostoja e nevojshme për implementimin e planit vlerësohet nën kushtet e mëposhtme:

Tabela 14: Kushtet për vlerësimin e kostos

Pikat	Supozimet
1. Ofruesi i Shërbimeve	Ofruesit e Shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave deri me 2018 janë Uniteti, dhe kompani private të cilat do të ofrojnë shërbimet e grumbullimit.
2. Zona e grumbullimit	Zona komunale ndahen në dy zona, dhe secili territor i shërbimit për ofruesin e shërbimit merret bazuar në territorin e mbuluar aktualisht.
3. Heqja e pikave ilegale	Puna për heqjen e pikave ilegale bëhet nga Uniteti dhe kompanitë tjera
4. Sasia e mbeturinave të grumbulluara	Sasia e mbeturinave të grumbulluara në secilën zone llogaritet duke përdorur formulën: shkalla e gjenerimit të mbeturinave x popullsia e zones x shkalla e grumbullimit të mbeturinave (pa përfshirë hedhjen ilegale).
5. Klasifikimi i zonave	Shkalla e gjenerimit për zonat urbane dhe zonat rurale përdoren siç janë dhënë më sipër
6. Distanca transportuese	Distanca transportuese është prej qendrës së zones deri në deponi në Gërmovë.
7. Frekuenca e shërbimit	Frekuenca e shërbimit pesë herë në javë, tre herë dhe një herë në javë.
8. Distanca e grumbullimit brenda zones së shërbimit	Distancat e udhëtimit për grumbullimin e mbeturinave janë 6 km në Vushtri dhe 5 km për zonat tjera.
9. Automjetet e grumbullimit	Automjetet grumbulluese janë kompaktor 7-9 t, minikompaorë 3-3,5t
10. Ritmi i mjetit transportues	Shpejtësia e automjetit grumbullues është 12.5 km/h (përfshirë punën e grumbullimit).
11. Koha e grumbullimit	Orari i punës është prej 7:30 p.d. deri 14:30 m.d. (orari i drekës 1 orë.), dhe koha e operimit 6 orë në ditë.
12. Distanca maksimale për transportim	Sipas të lartëpërmendurave, 10 & 11 maksimum distanca e udhëtimit është vlerësuar si 75 km/ditë.
13. Kostoja indirekte për punën e grumbullimit	Kostoja indirekte për punën e grumbullimit është 15% e kostos direkte sipas analizave financiare të të dhënave të pranuar nga Uniteti.
14. Ditët e punës	6 ditë në javë ( E Hënë – E Shtunë)
15. Kostoja e mirëmbajtjes	Kostoja e mirëmbajtjes vjetore është 6% e çmimit të automjetit
16. Shkalla e konsumit të derivative	Shkalla e konsumit të derivative është 0.5 litër/km.
17. Kostoja e derivative	Çmimi i derivative është 1.10€/litër dhe merret sipas berzes
18. Teprica	Teprica është 5% e shumës së kostos direkte dhe kostos indirekte.

### **5.3.2. Burimet e fondit**

#### **a. Kostoja e mbuluar nga të hyrat komunale**

Shpenzimet për pastrimin e hapësirave publike si fshirje, larje, heqja e bores, mirëmbajtja e parqeve, heqja e pikave ilegale etj. dhe shpenzimet e personelit të stafit të sektorit të menaxhimit të mbeturinave duhet të mbulohej nga të hyrat komunale.

#### **b. Kostoja e mbuluar nga taksa për mbeturina**

Kostoja për prokurimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave dhe implementimi i aktiviteteve për promovimin e minimizimit të mbeturinave dhe ngritjes së vetëdijesimit publik do të mbulohej nga Taksa për mbeturina e cila do të prezantohet së shpejti në mënyrë të krijimit të një sistemi të shëndoshë të menaxhimit të mbeturinave në Vushtri.

## **KAPITULLI VI**

### **6. Strategjia e implementimit të planit pesë-vjeçar për menaxhimin e mbeturinave**

#### **6.1 Publikimi dhe promovimi i planit të menaxhimit të mbeturinave**

Për të implementuar këtë plan të menaxhimit të mbeturinave, është e nevojshme të bashkëpunohet me qytetarët, bizneset afariste dhe qeverinë lokale. Prandaj, Komuna e Vushtrrisë publikon planin në webfaqen e Komunës dhe ofron informata përmes mediave elektronike dhe të shkruara.

Për ta implementuar planin me efikasitet duke reflektuar opinionin dhe kërkesat e qytetarëve dhe bizneseve afariste, Komuna e Vushtrrisë vendos kutinë e ankesave në objektin komunal. Kur pranohen ankesat nga qytetarët, Komuna e Vushtrrisë i drejtohet në mënyrë direkte ofruesit të shërbimeve dhe e udhëzon atë për përmirësimet e duhura sipas ankesës së pranuar.

#### **6.2 Krijimi i një ambienti të pastër përmes menaxhimit të mbeturinave drejt një shoqërie të shëndoshë**

##### **6.2.1 Të sigurohet qëndrueshmëria financiare**

Pasi që ofruesi i shërbimeve Uniteti nuk ka arritur të ofrojë shërbim të duhur dhe të kënaqshëm sepse shkalla e inkasimit në raport me faturimin ka qenë shumë e ultë prandaj edhe pikat e hedhjeve ilegale janë rritur.

Sipas Ligjit mbi mbeturinat, Komuna e Vushtrrisë ka vendosur ta prezantojë “Taksën për Mbeturina” për të siguruar mjetet e nevojshme për të ofruar shërbim të barabartë për të gjithë qytetarët.

Për ta prezantuar taksën për mbeturina, Komuna e Vushtrrisë cakton një tarifë të drejtë bazuar në sasinë e shkarkimit dhe kualitetin e shërbimit (p.sh.frekuencën etj.). Komuna e Vushtrrisë cakton një llogari të veçantë për menaxhimin e mbeturinave përmes sistemit të llogarisë komunale dhe i ndan të gjitha të hyrat nga taksa për mbeturina në këtë llogari të veçantë dhe e njëjta përdoret vetëm për menaxhimin e mbeturinave.

### **6.2.2 Të sigurohet shërbimi i duhur i grumbullimit të mbeturinave**

KRM Uniteti është një ndërmarrje publike e cila ka në operim tri njësi në komunat e regjionit të Mitrovicës. Pasi që Uniteti nuk ka pasur mundësitë të mbulojë gjithë zonën komunale, sektori privat ka ofruar shërbimin e grumbullimit dhe inkasimit në disa raste. Sidoqoftë, të hyrat nga pagesat për mbeturina janë më pak se gjysma e shumës së faturuar dhe me këtë edhe shërbimi nuk ka qenë i kënaqshëm si nga ana kualitative po ashtu edhe nga kuantiteti.

Siç u përmend më lartë, Komuna e Vushtrrisë do të bëjë mbledhjen e taksës për mbeturina nga qytetarët në mënyrë të drejtë dhe besueshmëri të gjerë dhe me këtë edhe financon shërbimet e grumbullimit të mbeturinave që nga viti 2016 duke e synuar zgjerimin e shtrirjes së shërbimit deri te të gjithë qytetarët.

Sektori i menaxhimit të mbeturinave bashkëpunon me qytetarë dhe monitoron nëse shërbimi i ofruar bëhet sipas planit operativ. Në mënyrë specifike, Komuna e Vushtrrisë krijon një njësi monitorimi brenda sektorit të menaxhimit të mbeturinave dhe inspektori monitoron tërë zonën komunale duke monitoruar veprimet e tyre.

### **6.2.3 Promovimi i aktiviteteve 3R**

Sasia e mbeturinave të gjeneruara rritet nga viti në vit.. Nëse e injorojmë këtë gjendje, jo vetëm që do të rritet kostoja e deponimit të mbeturinave por do të shkurtohet edhe jetëgjatësia e deponisë dhe pastaj duhet ngutur që të zbatohet PLMM. Prandaj, minimizimi i mbeturinave përmes aktiviteteve 3R janë mëse të nevojshme për krijimin e një menaxhimit të shëndoshë të mbeturinave në Vushtri.

Duke u fokusuar në mbeturinat e kuzhinës dhe vegjetacionit i cili llogaritet për 42.38% të mbeturinave, Komuna e Vushtrrisë promovon kompostimin në burim gjenerues. Kompostimi i mbeturinave organike pakëson vëllimin e mbeturinave dhe është efikas jo vetëm në reduktimin e metanit i cili është një gas i ngrohjes globale e cili gjenerohet në procesin e dekompozimit anaerobik por po ashtu shkakton edhe rrjedhjet të cilat ndotin ujërat.

#### **6.2.4 Promovimi i pjesëmarrjes publike**

Pasi që menaxhimi i mbeturinave është një nga shërbimet publike i cili nuk mund të administrohet vetëm nga një palë, pjesëmarrja publike është e domosdoshme. Sidoqoftë, aktivitetet për ngritjen e vetëdijesimit publik kërkojnë mjaft kohë dhe shpenzime. Komuna e Vushtrrisë i subvencionon ato aktivitete nga llogaria e veçantë për menaxhimin e mbeturinave duke promovuar edhe pjesëmarrjen publike.

Komuna ka besim se këto aktivitete do të pakësojnë vëllimin e mbeturinave, eliminojnë pikat ilegale të shkarkimit dhe do të lehtësojnë punën e grumbullimit duke bërë një shkarkim të përshtatshëm duke përcjellë rregullat të cilat rezultojnë edhe në reduktimin e kostos së menaxhimit të mbeturinave.

#### **6.3 Qartësimi i përgjegjësive të qytetarëve, bizneseve dhe qeverisë**

Komuna e Vushtrrisë, qytetarët dhe bizneset afariste duhet të ndërtojnë një sistem të duhur të menaxhimit të mbeturinave, duke marrë përgjegjësitë secili nga të përmendurit më lartë.

##### **6.3.1 Qytetarët**

###### **6.3.1.1 Pagesa e “Taksës për mbeturina”**

Qytetarët paguajnë taksën brenda afateve të caktuara nga Komuna e Vushtrrisë.

###### **6.3.1.2 Praktikrat e 3R**

###### Praktikat e Pakësimit

Qytetarët bëjnë përpjekje të pakësojnë mbeturinat duke zgjedhur paketime të thjeshta ose produkte të ripërdorshme. Për më shumë, qytetarët drejtohen në reduktimin e mbeturinave organike në një mënyrë pozitive duke përdorur komposterin.

###### Praktika e Ri-përdorimit

Qytetari ri-përdor gjësendin duke e riparuar ose duke e përdorur për qëllim tjetër, etj. para se ta hedh atë si mbeturinë.

###### Praktikat e Riciklimit

Qytetarët i ndajnë gjërat të cilat nuk mund të ripërdoren dhe i shkarkon ato si një burim. Qytetarët zgjedhin produkte të cilat ripërdoren ose kanë ndikim më të ulët në mjedis në kohën e blerjes.

### 6.3.1.3 Respektimi i rregullave të shkarkimit

Qytetarët përfillin mënyrat e shkarkimit të caktuara nga Komuna. Qytetarët të cilët jetojnë në ato pjesë të qytetit ku bëhet grumbullimi i veçantë i kartonëve dhe metaleve, i ndajnë gjërat e riciklueshme ashtu si duhet dhe konform udhëzimeve të dhëna nga komuna.

### 6.3.1.4 Bashkëpunimi aktiv në Plan

Qytetarët aktivisht bashkëpunojnë me masat e ndërmarra nga qeveria për implementim të menaxhimit të mbeturinave.

## 6.3.2 Bizneset afariste

### 6.3.2.1 Parimi ndotësi paguan

Bizneset afariste të shkallës së ulët që shkarkojnë mbeturinat bashkë me ato të amvisërisë duhet të paguajnë brenda afateve të caktuara nga Komuna e Vushtrrisë.

*Për zbatimin e këtij plani obligohen: kryetari i komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.*

*Ky plan hynë në fuqi 8 (tetë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.*

*Kryesuesi i Kuvendit*  
  
*Shpëtim Zhegrova*